



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 551/ 13 prot.

Datë 07/04/2026

V E N D I M
Nr. 477/2026

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Fiorent Zguro	Nënkryetar
Kreshnik Ternova	Anëtar
Anila Malaj	Anëtar
Gjergj Mersini	Anëtar

Në mbledhjen e datës 07/04/2026, mori në shqyrtim çështjen me,

Objekt: Mbi zbatimin e vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 443/2026, datë 30.30.2026 për procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur”, me Nr. REF-67572-11-03-2025, me objekt: “Sistemim Asfaltim i Rrugëve në territorin e Njësisë Administrative Fushë-Krujë, Bashkia Krujë”, me fond limit 197,903,543 (njëqind e nëntëdhjetë e shtatë milion e nëntëqind e tre mijë e pesëqind e dyzet e tre) lekë pa TVSH, zhvilluar më datë 19.11.2025, nga autoriteti kontraktor, Bashkia Krujë.

Ankimues: Operatori ekonomik “Udha” SHPK me NIPT K77524909Q me adresa: Lagjia “Pjetër Budi”, Rruga “Qamil Xhika”, Nd. 31, Burrel.

Operatori ekonomik “Bami Holding” SHPK me NIPT J94416206R, me adresa: Rruga Kameron, Krujë.

Autoriteti Kontraktor: Bashkia Krujë.
Adresa: Sheshi “Mustafa Merlika (Kruja)”, Krujë.

Baza Ligjore: Ligji nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e

Komisionit të Prokurimit Publik”, Neni 4 i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID - 19”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi shqyrtoi dokumentacionin e çështjes dhe e diskutoi në tërësi,

Vëren:

I

Rrethanat e çështjes

I.1. Në datë 30.03.2026, Komisioni i Prokurimit Publik mori vendimin Nr. 443/2026, ku vendosi:

1. Të pranojë ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “*Udha*” SHPK për procedurën e prokurimit “*Procedurë e hapur*”, me Nr. REF-67572-11-03-2025, me objekt: “*Sistemim Asfaltim i Rrugëve në territorin e Njesisë Administrative Fushë-Krujë, Bashkia Krujë*”, me fond limit 197,903,543 (njëqind e nëntëdhjetë e shtatë milion e nëntëqind e tre mijë e pesëqind e dyzet e tre) lekë pa TVSH, zhvilluar më datë 19.11.2025, nga autoriteti kontraktor, Bashkia Krujë.
2. Të pranojë ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “*Bami Holding*” SHPK për procedurën e prokurimit “*Procedurë e hapur*”, me Nr. REF-67572-11-03-2025, me objekt: “*Sistemim Asfaltim i Rrugëve në territorin e Njesisë Administrative Fushë-Krujë, Bashkia Krujë*”, me fond limit 197,903,543 (njëqind e nëntëdhjetë e shtatë milion e nëntëqind e tre mijë e pesëqind e dyzet e tre) lekë pa TVSH, zhvilluar më datë 19.11.2025, nga autoriteti kontraktor, Bashkia Krujë.
3. Autoriteti kontraktor të anulojë vendimin e KVO-së mbi skualifikimin e operatorit ekonomik “*Udha*” SHPK dhe të korrigjojë shkeljet e konstatuara si më sipër, duke e kualifikuar këtë operatorë ekonomik.
4. Autoriteti kontraktor të anulojë vendimin e KVO-së mbi skualifikimin e operatorit ekonomik “*Bami Holding*” SHPK dhe të korrigjojë shkeljet e konstatuara si më sipër, duke e kualifikuar këtë operatorë ekonomik.
5. Autoriteti kontraktor brenda 5 ditëve të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e vendimit, duke dokumentuar veprimet e kryera.
6. Ngarkohet zyra e financës, që të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “*Udha*” SHPK.

7. Ngarkohet zyra e financës, që të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “*Bami Holding*” SHPK.

8. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.

9. Kopje e këtij vendimi, i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

I.2. Me shkresën nr. 2411/1 prot, datë 01.04.2026, me objekt “*Dërgim informacioni*” protokolluar me tonën me nr. 551/10 prot, datë 03.04.2026, autoriteti kontraktor Bashkia Krujë, ka informuar Komisionin e Prokurimit Publik mbi zbatimin e vendimit KPP 443/2026, për procedurën e prokurimit “*Procedurë e hapur*”, me Nr. REF-67572-11-03-2025, me objekt: “*Sistemim Asfaltim i Rrugëve në territorin e Njësisë Administrative Fushë-Krujë, Bashkia Krujë*”, me fond limit 197,903,543 (njëqind e nëntëdhjetë e shtatë milion e nëntëqind e tre mijë e pesëqind e dyzet e tre) lekë pa TVSH, zhvilluar më datë 19.11.2025, nga autoriteti kontraktor, Bashkia Krujë.

II

Komisioni i Prokurimit Publik

Pasi shqyrtoi dokumentacionin e mësipërm,

Arsyeton

II.1. Me shkresën nr. 2411/1 prot, datë 01.04.2026, me objekt “*Dërgim informacioni*” protokolluar me tonën me nr. 551/10 prot, datë 03.04.2026, autoriteti kontraktor Bashkia Krujë, ka informuar Komisionin e Prokurimit Publik mbi zbatimin e vendimit KPP 443/2026, për procedurën e prokurimit “*Procedurë e hapur*”, me Nr. REF-67572-11-03-2025, me objekt: “*Sistemim Asfaltim i Rrugëve në territorin e Njësisë Administrative Fushë-Krujë, Bashkia Krujë*”, me fond limit 197,903,543 (njëqind e nëntëdhjetë e shtatë milion e nëntëqind e tre mijë e pesëqind e dyzet e tre) lekë pa TVSH, zhvilluar më datë 19.11.2025, nga autoriteti kontraktor, Bashkia Krujë.

Referuar shkresës së mësipërme, të dorëzuar nga autoriteti kontraktor, Komisioni vëren se, autoriteti kontraktor nëpërmjetë shkresës së mësipërcituar informon Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e vendimit nr. 443/2026 datë 30.03.2026, të KPP. Nga verifikimi në sistemin e prokurimit elektronik dhe raport auditit KPP konstaton se autoriteti kontraktor ka kryer rivlersimin e procedurës në zbatim të përcaktimeve të bëra në vendimin KPP 443/2026, datë 30.03.2026 për procedurën e prokurimit objekt ankimi, duke rishikuar statusin e operatorëve ekonomikë ankimues ku nga të skualifikuar rezultojn të kualifikuar. Ndaj në këto kushte, rezulton se autoriteti kontraktor ka marrë masat e nevojshme në zbatim të përcaktimeve të bëra në vendimin KPP 443/2026, datë 30.03.2026 për procedurën e prokurimit objekt ankimi.

Përsa më sipër, në mbështetje të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, nenit 4, të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos

1. Të lejojë autoritetin kontraktor për vijimin me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit “Procedurë e hapur”, me Nr. REF-67572-11-03-2025, me objekt: “Sistemim Asfaltim i Rrugëve në territorin e Njësisë Administrative Fushë-Krujë, Bashkia Krujë”, me fond limit 197,903,543 (njëqind e nëntëdhjetë e shtatë milion e nëntëqind e tre mijë e pesëqind e dyzet e tre) lekë pa TVSH, zhvilluar më datë 19.11.2025, nga autoriteti kontraktor, Bashkia Krujë.
2. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar
Kreshnik Ternova

Anëtar
Anila Malaj

Anëtar
Gjergj Mersini

Nënkryetar
Fiorent Zguro

